



Nga: **DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k.**
Autostrada Tiranë – Durrës, Rruga Dytësore, Kilometri 8, Tiranë.
NUIS J618200401

Drejtuar: **KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**
Rr. Ibrahim Rugova Nr. 4, 1007, Tiranë, Shqipëri.

Në vëmendjen e kujdesshme të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Z. Ilirjan Celibashi.

Lënda: **Kërkesë e përsëritur për pagesën e detyrimeve kontraktore.**

I nderuar Z. Celibashi,

Ju drejtohem i sërish, në vijim të Tonës, datë 10.7.2025, duke kërkuar nga ana e Institucionit që Ju përfaqësoni, pagesën e shumave të lindura si rrjedhojë e kontratës së shërbimit për shërbimin postar për zgjedhësit nga jashtë vendit Nr. 1358/20, datë 4.4.2025 (në vijim “Kontrata e Shërbimit”).

Siç sigurisht jeni në dijeni, shoqëria DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k., është shoqëri e kontrolluar nga Deutsche Post International, pjesë e shoqërisë publike gjermane Deutsche Post AG, dhe që prej viti 1993, ofron shërbime postare në Republikën e Shqipërisë, me të njëjtin standard garancie dhe sigurie si ato të ofruara nga shoqëria mëmë në Gjermani dhe në 220 vende të tjera të botës ku kjo e fundit operon.

Të njëjtin standard garancie, sigurie dhe serioziteti shoqëria DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k. zbatoi edhe në përmbushjen e shërbimeve postare sipas Kontratës së Shërbimit, duke asistuar Institucionin që Ju përfaqësoni të realizojë me sukses zbatimin e projektit ambicioz dhe inovativ për Shqipërinë, të votimit nëpërmjet postës për të gjithë atdhetarët tanë kudo që ndodheshin jashtë shtetit, i cili mund të konsiderohet tashmë një histori suksesi për Institucionin që përfaqësoni.

Arsyeja për të cilën Ju drejtohem i sërish, është se, pavarësisht kërkesave të njëpasnjëshme të përfaqësuesve të shoqërisë DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k. (lutem referojuni e-mail datë 26.5.2025, 28.5.2025, 10.6.2025 dhe 24.6.2025, si edhe së fundmi shkresa jonë datë 10.7.2025) rezultojnë ende të pa shlyera detyrimet e rrjedhura nga ofrimi i shërbimeve tona sipas Kontratës së Shërbimit.

Posaçërisht, siç përcaktohet në nenin 7 të Kontratës së Shërbimit “pagesa për shërbimet do të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të faturave të fiskalizuara për shërbimin së bashku me informacionin për çdo dërgesë (airwaybill) të përfunduar/dorëzuar”.

Në lidhje me këtë parashikim, lutem të informoheni se:

1. me shkresën datë 16.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/21, datë 17.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datave 14, 15 dhe 16.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
2. me shkresën datë 17.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/23, datë 18.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 17.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
3. me shkresën datë 18.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/22, datë 18.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 18.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
4. me shkresën datë 20.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/24, datë 21.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 19.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
5. me shkresën datë 21.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/25, datë 21.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 20.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
6. me shkresën datë 22.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/26, datë 22.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 22.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
7. me shkresën datë 23.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/32, datë 24.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të datës 23.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
8. me shkresën datë 25.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/33, datë 25.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 25.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
9. me shkresën datë 29.4.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/39, datë 29.4.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 28.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;

10. me shkresën datë 5.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/45, datë 5.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 30.4.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
11. me shkresën datë 5.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/46, datë 5.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 17, 18, 19, 20, 22, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30.4.2025, si edhe 1, 2, 3 dhe 4.5.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës
12. me shkresën datë 6.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/47, datë 6.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 5.5.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
13. me shkresën datë 9.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 4362, datë 12.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të nisura nga Shqipëria të datës 7.5.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
14. me shkresën datë 12.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/61, datë 13.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 7, 8 dhe 9.5.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
15. me shkresën datë 15.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 4562, datë 17.5.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 10 dhe 11.5.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
16. me shkresën datë 2.6.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 5040, datë 3.6.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datës 2.6.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
17. me shkresën datë 4.6.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 5077, datë 5.6.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 3 dhe 4.6.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;
18. me shkresën datë 11.6.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/65, datë 12.6.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 5, 9 dhe 11.6.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës;

19. me shkresën datë 20.6.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj më datë 23.6.2025, janë dorëzuar raportet e dërgesave të mbërritura në Shqipëri të datave 13, 17 dhe 18.6.2025, si edhe detajet përkatëse në CD bashkëlidhur shkresës.

Gjithashtu, lutemi të informoheni se:

20. me shkresën datë 9.5.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 1358/48, datë 9.5.2025, janë dorëzuar faturat e fiskalizuara respektivisht: nr. 8658/2025, nr. 8663/2025 dhe nr. 8667/2025, si edhe detajet përkatëse të faturimit në CD bashkëlidhur shkresës;

21. me shkresën datë 3.6.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 5104, datë 9.6.2025, janë dorëzuar faturat e fiskalizuara respektivisht: nr. 10761/2025, nr. 10762/2025 dhe nr. 10763/2025, si edhe detajet përkatëse të faturimit në CD bashkëlidhur shkresës;

22. me shkresën datë 9.7.2025, protokolluar pranë Institucionit Tuaj me Nr. 5509, datë 10.7.2025, janë dorëzuar faturat e fiskalizuara respektivisht: nr. 13614/2025 dhe nr. 13615/2025, si edhe detajet përkatëse të faturimit në CD bashkëlidhur shkresës.

Faturat e më sipërme janë transmetuar pranë institucionit Tuaj edhe nëpërmjet sistemit elektronik Platforma Qendrore e Faturave dhe rezultojnë rregullisht të pranuar nga ana e Institucionit Tuaj.

Për sa më sipër rezulton se, nga ana e shoqërisë DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k. janë përmbushur me përpikmëri detyrimet sipas Kontratës së Shërbimit, dhe janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 7 për kryerjen e pagesës së shumave përkatëse të rrjedhura si pasojë e shërbimeve të realizuara sipas Kontratës së Shërbimit.

Në bazë të sasisë së shërbimeve të ofruara nga ana e shoqërisë DHL INTERNATIONAL (Albania) sh.p.k. sipas Kontratës së Shërbimit, rezulton se vlera totale e detyrimit është në shumën prej 863'906'699 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e nëntëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë

Në shtesë të sa më sipër, bazuar në nenin 10.4 të Kontratës së Shërbimit, parashikohet se "në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014, <<Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare>>".

Në këto kushte, lutem të informoheni se, bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 kamatëvonesa që i aplikohet detyrimit si më sipër është 10.75% deri më datë 30.6.2025, dhe 10.5% për mos pagesë pas kësaj date e në vijim. Në bazë të këtyre përcaktimeve, ju bëjmë me dije se, kamatëvonesa që do të maturohej deri më datë 30.9.2025, në rast mos pagese, do të ishte në shumën prej, 26,014,829 (njëzetë e gjashtë

milion e katërmëdhjetë mijë e tetëgind e njëzetë e nëntë) Lekë e cila do t'i shtohet shumës së principalit të detyrimit si më sipër. Theksojmë se një zhvillim i tillë do të kishte pasoja financiare që mund të çonin në tejkalimin e parashikimeve buxhetore të përcaktuara në Kontratën e Shërbimit.

Nga ana jonë, i mirëkuptojmë vonesat e hasura nga ana e Institucionit Tuaj lidhur edhe me situatën e menaxhimit pas zgjedhor, dhe jemi të gatshëm të heqim dorë nga pagesa e kamatëvonesave të maturuara ndërkohë nëse nga ana e Institucionit Tuaj do të merren masa për kryerjen e pagesës së detyrimit principal sipas Kontratës së Shërbimit brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

Duke shprehur në mirëkuptimin Tuaj, mbetemi në pritje të një reagimi sa më të shpejtë nga ana Juaj.

Tiranë më 1.9.2025

Me konsideratë,

Për shoqërinë **DHL INTERNATIONAL (Albania) Sh.p.k.**,

Z. Qirjako Koçollari



DHL International (Albania) Ltd.